



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

**STRATEGJIA E KOMISIONERIT
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
2026 – 2030**

Tiranë 2026

Përmbajtja

Parathënie	3
Shkurtime dhe akronime	4
I. Përmbledhje Ekzekutive	5
II. Vizioni, Misioni dhe Vlerat	6
2.1 Vizioni	6
2.2 Misioni	6
2.3 Vlerat dhe parimet institucionale	7
III. Konteksti Strategjik.....	8
3.1 Kuadri ligjor kombëtar	8
3.2 Kuadri ndërkombëtar dhe evropian.....	8
3.3 Integrimi evropian	9
3.4 Bashkëpunimi institucional në nivel evropian dhe ndërkombëtar	10
3.5 Tendencat dhe zhvillimet strategjike	11
IV. Vlerësimi Strategjik (Analiza SWOT)	12
4.1 Pikat e forta	12
4.2 Dobësitë.....	13
4.3 Mundësitë	13
4.4 Kërcënimet	14
V. Analiza e Situatës.....	15
5.1 Situata aktuale në fushën e të drejtës për informim	15
5.2 Situata aktuale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale	16
5.3 Zgjerimi i mandatit institucional	17
5.4 Marrëdhëniet institucionale.....	17
5.5 Sfidat strategjike për periudhën 2026 – 2030.....	18
VI. Objektivat Strategjike	20
6.1 Objektivi Strategjik 1: Forcimi i transparencës dhe garantimi efektiv i së drejtës për informim	20
6.2 Objektivi Strategjik 2 – Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në shoqërinë digjitale	21
6.3 Objektivi Strategjik 3 – Forcimi i qeverisjes së hapur përmes konsultimit publik dhe të dhënave të hapura	22
6.4 Objektivi Strategjik 4 – Zbatimi efektiv i mandatit të Komisionerit në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit.....	23
6.5 Objektivi Strategjik 5 – Forcimi i efektivitetit institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve organizative	24
VII. Zbatimi dhe Monitorimi i Strategjisë	26
7.1 Zbatimi i Strategjisë	26
7.2 Monitorimi, raportimi dhe rishikimi	26
7.3 Burimet për zbatimin e Strategjisë	26
7.4 Menaxhimi i rreziqeve	27
ANEKSI I.....	28
Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë 2026 – 2027.....	28

Parathënie

Strategjia 2026 – 2030 shënon një etapë të re në zhvillimin institucional të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ajo pasqyron angazhimin tonë për të garantuar në mënyrë efektive të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, promovimin e të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit në sektorin publik si dhe veprimtarisë së lobimit.

Gjatë viteve të fundit, institucioni ka konsoliduar rolin e tij si autoritet i pavarur mbikëqyrës, duke forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes, rritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale, si dhe zhvilluar kapacitetet për përmbushjen efektive të mandatit të tij. Njëkohësisht, transformimi digjital, zhvillimi dhe përdorimi në rritje i inteligjencës artificiale, procesi i integritetit evropian dhe zgjerimi i kompetencave të institucionit, krijojnë sfida dhe mundësi të reja, të cilat kërkojnë një vizion të qartë strategjik dhe një qasje proaktive në ushtrimin e mandatit të Komisionerit.

Kjo Strategji shpreh angazhimin e institucionit për të forcuar kapacitetet mbikëqyrëse dhe organizative, për të rritur efektivitetin institucional dhe për të zhvilluar bashkëpunimin me autoritetet publike, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë. Në të njëjtën kohë, ajo synon të garantojë që veprimtaria e Komisionerit të zhvillohet në përputhje me standardet më të mira kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare.

Jam i bindur se zbatimi i kësaj Strategjie do të kontribuojë në forcimin e besimit të publikut ndaj institucioneve, në konsolidimin e një administrate publike më transparente, më të përgjegjshme dhe më të hapur, duke promovuar një kulturë të transparencës, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të individit.

Besnik Dervishi

Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Shkurtime dhe akronime

Shkurtimi	Emërtimi i plotë
Zyra e Komisionerit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
BE	Bashkimi Evropian
GDPR	Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave
LED	Direktiva (BE) 2016/680 për mbrojtjen e të dhënave në fushën penale
EDPB	European Data Protection Board
GPA	Global Privacy Assembly
ICIC	International Conference of Information Commissioners
RENKP	Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike
REKPMI	Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
KPI	Treguesit Kryesorë të Performancës
IA	Inteligjenca Artificiale
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
DPO	Nëpunësi i Mbrojtjes së të Dhënave
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik

I. Përmbledhje Ekzekutive

Strategjia e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026 – 2030 (në vijim “Zyra e Komisionerit”) paraqet vizionin, prioritetet dhe drejtimit strategjike për zhvillimin e institucionit gjatë pesë viteve të ardhshme, në funksion të forcimit të mbrojtjes së të drejtës për informim, mbrojtjes së të dhënave personale, promovimin e të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit në sektorin publik si dhe veprimtarisë së lobimit.

Strategjia është hartuar në një kontekst të karakterizuar nga zhvillimet e shpejta teknologjike, transformimi digjital, procesi i integritetit evropian dhe zgjerimi i kompetencave të Komisionerit. Këto zhvillime krijojnë mundësi të reja për forcimin e transparencës dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të individit, por njëkohësisht sjellin sfida të reja që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, përdorimin e inteligjencës artificiale, qeverisjen e të dhënave, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje dhe garantimin e integritetit të proceseve publike.

Strategjia është hartuar mbi bazën e analizës së kuadrit ligjor kombëtar dhe evropian, dokumenteve strategjike kombëtar dhe atyre të Bashkimit Evropian hartuar në kuadër të procesit të integritetit, standardeve ndërkombëtare, analizës së situatës, analizës SWOT, vlerësimit të kapaciteteve institucionale të Komisionerit si dhe sfidave të identifikuara në ushtrimin e mandateve të tij.

Strategjia ndërtohet mbi vizionin që transparenca publike dhe mbrojtja e të dhënave personale përbëjnë garanci themelore të demokracisë në epokën digjitale. Në këtë kuadër, misioni i Komisionerit është të garantojë ushtrimin efektiv të së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke promovuar transparencën, llogaridhënien, integritetin institucional dhe respektimin e të drejtave themelore të qytetarëve.

Për realizimin e këtij vizioni, Strategjia përcakton pesë objektiva strategjike: (i) forcimin e transparencës dhe garantimin efektiv të së drejtës për informim; (ii) garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në shoqërinë digjitale; (iii) forcimin e qeverisjes së hapur përmes konsultimit publik dhe të dhënave të hapura; (iv) zbatimin efektiv të mandatit të Komisionerit në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit; (v) forcimin e efektivitetit institucional dhe zhvillimin e kapaciteteve organizative. Këta objektiva përkthehen në prioritate strategjike, masa konkrete dhe tregues të performancës, të detajuara në kapitujt vijues të Strategjisë dhe në Planin e Veprimit 2026 – 2027.

Zbatimi i Strategjisë do të realizohet nëpërmjet planeve periodike të veprimit, të miratuara nga Komisioneri, ku do të përcaktohen masat konkrete, strukturat përgjegjëse, afatet dhe treguesit e performancës. Plani i parë i Veprimit mbulon periudhën 2026 – 2027. Plani pasues për periudhën 2028 – 2030 do të hartohet dhe miratohet brenda vitit 2027, mbi bazën e rezultateve të monitorimit dhe prioritetëve institucionale. Monitorimi i Strategjisë do të bazohet në raportimin gjashtëmujor të strukturave përgjegjëse, ndjekjen e treguesve të performancës dhe vlerësimin vjetor të rezultateve. Strategjia do t’i nënshtrohet një rishikimi afatmesëm dhe, kur është e nevojshme, përditësimit për t’u përshtatur me zhvillimet ligjore, institucionale, teknologjike si dhe me procesin e integritetit evropian.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj Strategjie, Komisioneri synon të konsolidojë më tej rolin e tij si autoritet i pavarur mbikëqyrës, të forcojë besimin e publikut ndaj institucioneve, të kontribuojë në zhvillimin e një administrate publike më transparente, më të përgjegjshme dhe më të hapur, si dhe të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të qytetarëve në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Kjo Strategji është hartuar me mbështetjen e projektit PACEP II, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe i zbatuar nga Global Partners Governance (GPG) Albania.

II. Vizioni, Misioni dhe Vlerat

2.1 Vizioni

"Transparenca, mbrojtja e të dhënave personale dhe integriteti në vendimmarrje janë garanci themelore të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në epokën digjitale."

Vizioni i Zyrës së Komisionerit për periudhën 2026 – 2030 është konsolidimi i institucionit si një autoritet i pavarur, efektiv, proaktiv dhe i besueshëm, që garanton të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, promovon transparencën përmes të dhënave të hapura dhe konsultimit publik, si dhe forcon integritetin në proceset e vendimmarrjes publike, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Përmes këtij vizioni, Komisioneri do të kontribuojë në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike, promovimin e një kulture të transparencës, përgjegjshmërisë dhe respektimit të të drejtave themelore, si dhe në rritjen e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.

Në një mjedis të karakterizuar nga transformimi digjital, zhvillimi i inteligjencës artificiale, qeverisja e të dhënave dhe rritja e përdorimit të tyre, Zyra e Komisionerit do të veprojë si një institucion që jo vetëm garanton zbatimin efektiv të legjislacionit, por edhe identifikon, parashikon dhe adreson në mënyrë proaktive sfidat që lidhen me të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, konsultimin publik dhe transparencën e proceseve të vendimmarrjes publike.

Duke ndjekur zhvillimet teknologjike, ligjore dhe institucionale që ndikojnë në fushat e përgjegjësisë së tij, Komisioneri do të kontribuojë në ndërtimin e një mjedisi të sigurt, transparent dhe të besueshëm për qytetarët, institucionet publike dhe subjektet private, duke kontribuar në zhvillimin e një administrate publike transparente, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt qytetarit.

Realizimi i këtij vizioni mbështetet në profesionalizëm, pavarësi, integritet, inovacion dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet publike, sektorin privat, shoqërinë civile, akademinë dhe partnerët ndërkombëtarë, me synimin për të forcuar një kulturë të qëndrueshme të transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale, integritetit, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave themelore.

2.2 Misioni

Misioni i Zyrës së Komisionerit është të garantojë zbatimin efektiv të legjislacionit në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe të ushtrojë kompetencat ligjore në fushën e të dhënave të hapura, njoftimit dhe konsultimit publik dhe transparencës së veprimtarisë së lobimit, nëpërmjet funksioneve mbikëqyrëse, rregullatore, vendimmarrëse, këshilluese, ndërgjegjësuere dhe bashkëpunuese, në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe standardet evropiane.

Në përmbushje të këtij misioni, Komisioneri monitoron zbatimin e legjislacionit në fushat ku ligji i njeh kompetenca mbikëqyrëse, shqyrton ankesat administrative, zhvillon hetime dhe inspekte, monitoron përmbushjen e detyrimeve ligjore, harton dhe miraton akte rregullatore e udhëzuese, jep rekomandime për përmirësimin e praktikave administrative dhe kuadrit ligjor, si dhe promovon ndërgjegjësimin publik dhe zhvillimin e kapaciteteve.

Zyra e Komisionerit bashkëpunon ngushtë me institucionet publike, sektorin privat, shoqërinë civile, akademinë dhe partnerët ndërkombëtarë, me qëllim harmonizimin e legjislacionit dhe praktikave kombëtare me standardet evropiane, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së të drejtave të individit.

2.3 Vlerat dhe parimet institucionale

Veprimtaria e Zyrë së Komisionerit dhe zbatimi i Strategjisë 2026 – 2030 mbështeten në një sistem vlerash dhe parimesh që udhëheqin ushtrimin e mandatit institucional dhe marrëdhëniet me qytetarët, institucionet publike, subjektet private dhe partnerët ndërkombëtarë. Këto vlera dhe parime pasqyrojnë standardet kushtetuese, legjislacionin kombëtar dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantojnë të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, transparencën, integritetin dhe qeverisjen e mirë. Zyra e Komisionerit ushtron veprimtarinë e saj mbi bazën e këtyre vlerave dhe parimeve themelore:

- **Pavarësia** – ushtrimi i mandatit në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje apo ndikime të papërshtatshme politike, institucionale apo private;
- **Ligjshmëria** – respektimi i Kushtetutës, legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare në çdo aspekt të veprimtarisë institucionale;
- **Integriteti** – ushtrimi i kompetencave me ndershmëri, etikë profesionale dhe përgjegjshmëri, në shërbim të interesit publik;
- **Profesionalizmi** – garantimi i standardeve të larta profesionale, zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve dhe cilësia e vendimmarrjes institucionale;
- **Orientimi ndaj qytetarit** – vendosja e mbrojtjes së të drejtave dhe interesit të ligjshëm të qytetarit në qendër të veprimtarisë institucionale, duke garantuar aksesueshmëri, komunikim të hapur dhe shërbime cilësore;
- **Paanësia dhe objektiviteti** – trajtimi i çdo çështjeje në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe të bazuar në fakte e në ligj;
- **Proporcionaliteti** – balancimi i interesit publik me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit;
- **Transparenca dhe llogaridhënia** – ushtrimi i kompetencave në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, duke promovuar qeverisjen e hapur dhe besimin e publikut;
- **Konfidencialiteti** – garantimi i mbrojtjes së informacionit dhe të dhënave personale gjatë ushtrimit të funksioneve ligjore;
- **Barazia dhe mosdiskriminimi** – sigurimi i trajtimit të barabartë dhe respektimit të dinjitetit të çdo individi, pa asnjë formë diskriminimi;
- **Inovacioni** – nxitja e përmirësimit të vazhdueshëm dhe përshtatja me zhvillimet teknologjike për rritjen e efektivitetit institucional;
- **Bashkëpunimi institucional** – zhvillimi i partneriteteve efektive me institucionet publike, sektorin privat, shoqërinë civile, akademinë dhe partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen efektive të mandatit institucional.

Këto vlera dhe parime përbëjnë themelin mbi të cilin Komisioneri ushtron mandatin e tij kushtetues dhe ligjor. Ato udhëheqin vendimmarrjen institucionale, marrëdhëniet me publikun dhe partnerët, si dhe zbatimin e objektivave strategjikë të kësaj Strategjie, duke garantuar që veprimtaria e institucionit të mbetet në shërbim të mbrojtjes së të drejtave themelore, transparencës, integritetit dhe shtetit të së drejtës.

III. Konteksti Strategjik

3.1 Kuadri ligjor kombëtar

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit mbështetet në një kuadër të konsoliduar kushtetues dhe ligjor, i cili garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të individit.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përbën bazën e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit, duke garantuar të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe parimet e shtetit të së drejtës, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Mbi këto garanci kushtetuese mbështetet ushtrimi i funksioneve dhe kompetencave të Komisionerit.

Në zbatim të këtyre parimeve, kuadri ligjor kombëtar përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e Komisionerit në fushat kryesore të veprimtarisë së tij. Në fushën e transparencës dhe qeverisjes së hapur, kompetencat e institucionit mbështeten në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe ligjin nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Ky kuadër garanton të drejtën e aksesit në informacion dhe transparencën proaktive; i njeh Komisionerit kompetenca për shqyrtimin e ankesave në fushën e konsultimit publik; si dhe përcakton funksionet e tij në mbikëqyrjen dhe promovimin e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri ushtron funksionet e tij në zbatim të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i harmonizuar me acquis të Bashkimit Evropian. Ky ligj përcakton standardet për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, garanton të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe konsolidon rolin e Komisionerit si autoriteti kombëtar mbikëqyrës në këtë fushë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, kompetencat e Komisionerit janë zgjeruar edhe në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit. Ligji i ngarkon institucionit administrimin dhe publikimin e Regjistrit të Lobimit, mbikëqyrjen e përmbushjes së detyrimeve ligjore, trajtimin e kundërvajtjeve administrative dhe raportimin vjetor për zbatimin e tij.

Veprimtaria e Komisionerit mbështetet gjithashtu në legjislacionin sektorial dhe aktet nënligjore që rregullojnë procedurat administrative, organizimin dhe funksionimin e autoriteteve publike, si dhe ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse në fushat e përgjegjësisë së tij. Në tërësi, ky kuadër ligjor krijon bazën për ushtrimin e një funksioni të pavarur, efektiv dhe në zhvillim të vazhdueshëm, në përputhje me standardet kushtetuese dhe objektivat e procesit të integritetit evropian.

Ky kuadër ligjor kombëtar plotësohet nga instrumentet ndërkombëtare dhe evropiane, të cilat orientojnë zhvillimin e legjislacionit kombëtar dhe ushtrimin e mandatit të Komisionerit në përputhje me standardet më të avancuara ndërkombëtare.

3.2 Kuadri ndërkombëtar dhe evropian

Veprimtaria e Komisionerit zhvillohet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, që rregullojnë të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, transparencën dhe funksionimin e autoriteteve të pavarura mbikëqyrëse. Këto instrumente përbëjnë një pikë të rëndësishme reference për zhvillimin e legjislacionit kombëtar, ushtrimin e kompetencave të Komisionerit dhe përafrimin e praktikave institucionale me standardet evropiane.

Në fushën e të drejtës për informim, një referencë themelore përbën Konventa e Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsøs, njohur ndryshe si “Konventa 205”), e cila garanton zbatimin e standardeve më të larta ndërkombëtare për aksesin e qytetarëve në informacionin/dokumentacionin që prodhojnë/ruajnë autoritetet publike. Konventa ka në thelb parimin e transparencës së tyre në funksion të mirëqeverisjes, për forcimin e demokracisë dhe shtetit

të së drejtës. Shqipëria ka ratifikuar këtë Konventë nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 45/2022, datë 28.04.2022, ku Zyra e Komisionerit është caktuar si përfaqësuese e vendit në Këshillin e Palëve të Konventës 205.

Sa i përket legjislacionit të Bashkimit Evropian në këtë fushë, në muajin prill të vitit 2023, hyri në fuqi ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, i cili transpozon Direktivën e BE-së me po të njëjtën titull, duke i shtuar një kompetencë të re Zyrës së Komisionerit në mbikëqyrjen dhe promovimin e kësaj të drejte. Nëpërmjet këtij ligji garantohet një politikë e qartë dhe e posaçme në këtë drejtim, duke inkurajuar disponueshmërinë e gjerë dhe mundësinë e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik për qëllime private dhe tregtare.

Gjithashtu, në kuadër të procesit të integritetit të vendit në BE, është miratuar ligji nr.12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka për qëllim krijimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës dhe të qartë për rregullimin e veprimtarisë së lobimit në Republikën e Shqipërisë. Ky kuadër ligjor ka për objektiv garantimin e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes efektive të subjekteve që ushtrojnë ndikim mbi proceset e vendimmarrjes publike. Në zbatim të këtij ligji, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës i caktuar për të regjistruar, mbikëqyrur dhe kontrolluar ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, si dhe për të garantuar zbatimin e rregullave për transparencën dhe integritetin në proceset e lobimit. Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, kuadri ndërkombëtar mbështetet në Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale (Konventa 108), e cila përbën instrumentin e vetëm ndërkombëtar detyrues në këtë fushë dhe vendos parimet themelore për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, respektimin e të drejtave të individit dhe funksionimin e autoriteteve të pavarura mbikëqyrëse. Me qëllim për t’iu përgjigjur sfidave të zhvillimit ekonomik e shoqëror, e sidomos atyre teknologjike, në përmbushje të rekomandimeve të adresuara ndër vite nga dokumente ndërkombëtare, Shqipëria ka ratifikuar Protokollin ndryshues (CETS No. 223) të kësaj Konvente (njohur ndryshe si Konventa 108+), nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 49/2022, datë 12.05.2022. Në kuadër të procesit të integritetit evropian, veprimtaria e Zyrës së Komisionerit orientohet gjithashtu nga *acquis* të Bashkimit Evropian në këtë fushë, konkretisht Rregullorja (BE) 2016/679 (GDPR) dhe Direktiva (BE) 2016/680 (Law Enforcement Directive – LED), të cilat përcaktojnë standardet për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe që janë transpozuar në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale me miratimin e ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Një komponent i rëndësishëm i kuadrit ndërkombëtar është edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 113/2018. Zyra e Komisionerit, në përmbushje të kësaj Marrëveshje, ka rol të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të detyrimeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale gjatë veprimtarisë së strukturave të prokurorisë shqiptare. Kjo Marrëveshje ka përcaktuar shkëmbimin e rregullt të pikëpamjeve, mes Zyrës së Komisionerit dhe EUROJUST në lidhje me zbatimin e saj dhe zhvillimet e mëtejshme në këtë fushë dhe sigurisë së të dhënave personale. Për këtë qëllim, Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i EUROJUST dhe autoriteti shqiptar i raportojnë njëri-tjetrit të paktën një herë në vit. Në tërësi, standardet ndërkombëtare dhe evropiane jo vetëm që kanë orientuar zhvillimin e legjislacionit shqiptar në fushat e përgjegjësisë së Komisionerit, por përbëjnë edhe bazën për zhvillimin institucional, forcimin e pavarësisë, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet më të avancuara evropiane.

3.3 Integrimi evropian

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një objektiv strategjik kombëtar, ku Zyra e Komisionerit, si pjesë e Kapitullit “Kriteri politik”, Reforma në Administratën Publike, Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, Funksionimi i Institucioneve Demokratike dhe Kapitullit 10

“Shoqëria e informacionit dhe media”, ka dhënë kontributin e saj në të gjitha fazat e procesit të hapjes së negociatave. Kjo ecuri përmbledh një tërësi aktivitesh, raportimesh, bashkëpunimesh dhe takimesh, të cilat në përgjigje të sfidave të integritit, synojnë të arrijnë brenda kornizave strategjike afat-mesme dhe afat-gjata, objektiva të cilat i shërbejnë zhvillimit të institucioneve demokratike, transparencës në vendimmarrjen e të gjitha niveleve, si dhe forcimit e shtetit të së drejtës.

Në këtë kuadër, procesi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian përbën një nga faktorët kryesorë që orienton veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit gjatë periudhës 2026 – 2030. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me acquis të BE ka sjellë zhvillime të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, transparencës, qeverisjes së hapur dhe forcimit të institucioneve të pavarura. Në këtë kuadër, Komisioneri luan një rol kyç jo vetëm në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, por edhe në promovimin e standardeve evropiane, mbështetjen e institucioneve publike dhe zhvillimin e praktikave administrative në përputhje me kërkesat e procesit të integritit.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025 vlerëson miratimin e kuadrit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, por thekson nevojën për zbatim efektiv dhe forcim të kapaciteteve administrative e buxhetore të Zyrës së Komisionerit. Raporti evidenton gjithashtu se autoritetet publike duhet të përmirësojnë përputhshmërinë me kërkesat e transparencës dhe përgjegjshmërinë ndaj kërkesave për informacion, ndërsa proceset e konsultimit publik kërkojnë ndjekje më të rregullt, në kohë dhe transparente. Në të njëjtën kohë, procesi i integritit evropian kërkon që Komisioneri të vijojë harmonizimin e praktikave institucionale me standardet e Bashkimit Evropian, të forcojë bashkëpunimin me autoritetet homologe dhe institucionet evropiane, si dhe të zhvillojë kapacitete profesionale që mundësojnë zbatimin efektiv të legjislacionit dhe adresimin e sfidave të reja që lidhen me transformimin teknologjik, qeverisjen e të dhënave dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Në këtë kontekst, këto gjetje orientojnë prioritetet e Strategjisë 2026 – 2030, e cila përfaqëson një instrument të rëndësishëm për konsolidimin e rolit të Komisionerit si një institucion i pavarur, efektiv dhe i besueshëm, në përputhje me standardet dhe vlerat e Bashkimit Evropian.

3.4 Bashkëpunimi institucional në nivel evropian dhe ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një komponent të rëndësishëm të zhvillimit institucional të Zyrës së Komisionerit dhe mbështet realizimin e mandatit të saj në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja aktive në rrjete profesionale dhe mekanizma ndërkombëtarë i mundëson institucionit të shkëmbejë përvoja, të ndjekë zhvillimet më të fundit në fushën e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe të kontribuojë në zhvillimin e standardeve dhe praktikave të mira ndërkombëtare.

Në fushën e të drejtës për informim, Komisioneri është anëtar aktiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerve për të Drejtën e Informimit (ICIC), platforma më e rëndësishme globale e autoriteteve të pavarura për të drejtën e informimit. Pjesëmarrja në këtë rrjet mundëson shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare, promovimin e transparencës dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve homologe në trajtimin e sfidave të përbashkëta që lidhen me qeverisjen e hapur, administratën digjitale dhe balancimin ndërmjet transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Një arritje me rëndësi të veçantë për institucionin është zgjedhja e Komisionerit në rolin e Presidentit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerve për të Drejtën e Informimit (ICIC) për periudhën 2025 – 2027, duke i besuar Shqipërisë drejtimin e këtij rrjeti global. Ky rol forcon profilin ndërkombëtar të institucionit, rrit mundësitë për të kontribuar në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtës për informim dhe krijon mundësi të reja për bashkëpunim institucional dhe zhvillim të kapaciteteve profesionale.

Në kuadër të Konventës së Këshillit të Evropës për Aksesin në Dokumentet Zyrtare (Konventa e Tromsøs), Komisioneri përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Këshillin e Palëve, duke kontribuar

në monitorimin e zbatimit të Konventës, shkëmbimin e përvojave ndërmjet vendeve anëtare dhe promovimin e standardeve ndërkombëtare për transparencën dhe të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit bashkëpunon me rrjetet dhe mekanizmat kryesorë ndërkombëtarë, ndër të cilët Asamblenë Globale të Privatësisë (GPA), Bordi Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB), ku institucioni gëzon statusin e vëzhguesit të përhershëm që prej vitit 2016, dhe mekanizmat e Këshillit të Evropës në kuadër të Konventës 108+. Këto platforma kontribuojnë në harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet ndërkombëtare, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e përvojave mbi çështje të tilla si përpunimi ndërkufitar i të dhënave, inteligjenca artificiale, qeverisja e të dhënave dhe siguria kibernetike.

Pjesëmarrja në këto rrjete dhe mekanizma ndërkombëtarë kontribuon në forcimin e rolit institucional të Komisionerit, harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes në fushat e përgjegjësisë së tij.

3.5 Tendencat dhe zhvillimet strategjike

Periudha 2026–2030 karakterizohet nga zhvillime të shpejta teknologjike, institucionale dhe shoqërore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si ushtrohen e drejta për informim, mbrojtja e të dhënave personale dhe transparenca e institucioneve publike.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme është rritja e përdorimit të teknologjive digjitale si dhe inteligjencës artificiale në sektorin publik dhe atë privat. Akti i Bashkimit Evropian për Inteligjencën Artificiale dhe nënshkrimi nga Shqipëria, më 15 qershor 2026, i Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës e forcojnë nevojën për një qasje të bazuar në të drejta dhe në rrezik.

Një tjetër tendencë është zgjerimi i përdorimit dhe shkëmbimit të të dhënave, si brenda administratës publike, ashtu edhe ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Kjo kërkon forcimin e mekanizmave të qeverisjes së të dhënave, garantimin e standardeve të larta të sigurisë dhe zhvillimin e praktikave që balancojnë nevojën për inovacion me mbrojtjen e të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, qytetarët kërkojnë gjithnjë e më shumë transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes publike.

Një zhvillim me rëndësi të veçantë në nivel kombëtar është hyrja në fuqi e kuadrit ligjor për transparencën e veprimtarisë së lobimit, i cili zgjeron rolin e Komisionerit në promovimin e integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike. Zbatimi efektiv i këtij kuadri kërkon krijimin e mekanizmave të rinj të mbikëqyrjes, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e një kulture të transparencës në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve që ushtrojnë veprimtari lobuese.

Procesi i integritetit evropian dhe harmonizimi i vazhdueshëm me *acquis* dhe standardet e Bashkimit Evropian do të vijojnë të ndikojnë në zhvillimin e legjislacionit dhe praktikave institucionale në fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit.

Përballë këtyre zhvillimeve, Strategjia 2026 – 2030 synon të forcojë aftësinë institucionale të Zyrës së Komisionerit për të vepruar në mënyrë proaktive, të bazuar në analizë, bashkëpunim ndërinstytucional dhe standarde ndërkombëtare, duke siguruar që zhvillimet teknologjike, ligjore dhe institucionale të shoqërohen me garantimin efektiv të të drejtave themelore të individit.

IV. Vlerësimi Strategjik (Analiza SWOT)

Analiza SWOT përbën një instrument të rëndësishëm të planifikimit strategjik, i cili mundëson vlerësimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në realizimin e mandatit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet kësaj analize identifikohen pikat e forta dhe dobësitë e institucionit, si dhe mundësitë dhe kërcënimet që burojnë nga mjedisi i jashtëm, duke krijuar bazën për përcaktimin e objektivave strategjike dhe prioritetet e zhvillimit për periudhën 2026 – 2030. Vlerësimi strategjik mbështetet në analizën e kuadrit ligjor dhe institucional, raporteve të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe OECD/SIGMA, si dhe në përvojën e institucionit në ushtrimin e funksioneve të tij.

Analiza merr në konsideratë gjithashtu zgjerimin e mandatit institucional me kompetencat në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit, zhvillimet në teknologjitë digjitale dhe inteligjencën artificiale, si dhe procesin e integritetit evropian.

4.1 Pikat e forta

Zyra e Komisionerit gëzon një sërë avantazhesh institucionale që krijojnë një bazë të qëndrueshme për realizimin e misionit dhe objektivave strategjike për periudhën 2026 – 2030. Këto pika të forta lidhen me mandatin e konsoliduar ligjor, pavarësinë institucionale, ekspertizën e krijuar ndër vite, reputacionin e institucionit, si dhe angazhimin aktiv në proceset kombëtare dhe ndërkombëtare, që lidhen me transparencën, mbrojtjen e të dhënave personale dhe qeverisjen e mirë.

Pikat kryesore të forta të institucionit janë:

- Mandat ligjor i qartë, i gjerë dhe në zhvillim të vazhdueshëm, që mbulon të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, konsultimin publik, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit në sektorin publik si dhe transparencën e veprimtarisë së lobimit;
- Pavarësi institucionale dhe funksionale, e garantuar me ligj, që mundëson ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse, rregullatore dhe vendimmarrëse në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe profesionale;
- Eksperiencë e konsoliduar në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, trajtimin e ankesave administrative, zhvillimin e hetimeve dhe promovimin e praktikave të mira;
- Ekspertizë profesionale e specializuar, e ndërtuar ndër vite në fushat e transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbikëqyrjes administrative;
- Kapacitet për të ushtruar funksione rregullatore, këshilluese dhe monitoruese në mbështetje të zbatimit të legjislacionit dhe përmirësimit të politikave publike;
- Rol i konsoliduar në promovimin e transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave themelore, nëpërmjet veprimtarisë mbikëqyrëse, rregullatore dhe ndërgjegjëse;
- Reputacion institucional dhe besueshmëri të konsoliduar në bashkëpunimin me institucionet publike, sektorin privat, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- Angazhim aktiv në rrjetet dhe mekanizmat ndërkombëtarë, përfshirë Konferencën Ndërkombëtare të Komisionerve për të Drejtën e Informimit, Asamblenë Globale të Privatësisë (GPA), Bordin Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave (EDPB), në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm, si dhe mekanizmat e Këshillit të Evropës;
- Ushtrimi i Presidencës së Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC) për periudhën 2025 – 2027, e cila forcon profilin ndërkombëtar të institucionit dhe pozicionin e tij në zhvillimin e standardeve globale në fushën e të drejtës për informim;
- Bashkëpunim i konsoliduar me institucionet publike, organizatat ndërkombëtare, partnerët e zhvillimit, shoqërinë civile dhe rrjetet profesionale, i cili ka kontribuar në zhvillimin e

kapaciteteve institucionale, harmonizimin me standardet evropiane dhe promovimin e praktikave më të mira.

4.2 Dobësitë

Pavarësisht progresit të arritur në konsolidimin e rolit institucional, analiza eidenton një sërë faktorësh të brendshëm që ndikojnë në efektivitetin e plotë të ushtrimit të mandatit të Komisionerit. Këta faktorë lidhen kryesisht me kapacitetet organizative, njerëzore dhe teknologjike, si dhe me nevojën për përshtatjen e vazhdueshme të institucionit ndaj zgjerimit të mandatit dhe zhvillimeve të shpejta në mjedisin digjital.

Dobësitë kryesore të identifikuara janë:

- Burime njerëzore dhe financiare ende të kufizuara në raport me zgjerimin e mandatit institucional, rritjen e volumit të punës dhe nevojën për ekspertizë të specializuar;
- Kapacitete profesionale që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm në fusha të reja, si inteligjenca artificiale, qeverisja e të dhënave, siguria e informacionit dhe transparenca e veprimtarisë së lobimit;
- Sisteme informacioni dhe procese digjitale që kërkojnë modernizim të mëtejshëm, me qëllim rritjen e efikasitetit administrativ, përmirësimin e menaxhimit të ankesave, monitorimit dhe raportimit;
- Mekanizma që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm për monitorimin e performancës institucionale, përfshirë përdorimin e indikatorëve të performancës (KPI), analizës së të dhënave dhe planifikimit të bazuar në evidencë;
- Kapacitete të kufizuara për zgjerimin e aktiviteteve të edukimit, ndërgjegjësimit dhe komunikimit publik, veçanërisht për kategori të veçanta të publikut dhe autoriteteve publike.

4.3 Mundësitë

Mjedisi i jashtëm krijon mundësi të rëndësishme për zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të rolit të Komisionerit. Procesi i integritetit evropian, zhvillimet teknologjike, rritja e kërkesës për transparencë dhe qeverisje të mirë, si dhe bashkëpunimi me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë krijojnë kushte të favorshme për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e efektivitetit të mandatit të Komisionerit.

Mundësitë kryesore të identifikuara janë:

- Procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, i cili mbështet harmonizimin e legjislacionit, forcimin e institucioneve të pavarura dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative;
- Zhvillimi i qeverisjes së hapur (Open Government) dhe politikave për të dhënat e hapura, të cilat krijojnë mundësi për rritjen e transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe llogaridhënies së institucioneve publike;
- Transformimi digjital i administratës publike, i cili krijon mundësi për modernizimin e proceseve të punës, përmirësimin e shërbimeve publike dhe rritjen e efikasitetit institucional;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi të drejtën për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, transparencën dhe integritetin në vendimmarrjen publike;
- Zbatimi i legjislacionit për lobimin, i cili krijon mundësi për forcimin e rolit mbikëqyrës dhe këshillimor të Komisionerit në promovimin e transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike;
- Mbështetja teknike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë, për zhvillimin e kapaciteteve institucionale, modernizimin e proceseve dhe përafrimin me standardet evropiane;

- Bashkëpunimi me institucionet publike, shoqërinë civile, akademinë, median dhe sektorin privat, për promovimin e kulturës së transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale dhe edukimit qytetar;
- Zhvillimi i teknologjive të reja dhe mjeteve analitike, të cilat krijojnë mundësi për përmirësimin e monitorimit, analizës së të dhënave, vlerësimit të rreziqeve dhe efektivitetit të veprimtarisë mbikëqyrëse;
- Pjesëmarrja aktive në rrjetet dhe mekanizmat ndërkombëtarë, e cila krijon mundësi për shkëmbimin e praktikave më të mira, zhvillimin profesional të stafit, harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe rritjen e profilit institucional.

4.4 Kërcënimet

Veprimtaria e Komisionerit ndikohet nga një sërë faktorësh të jashtëm që mund të kufizojnë efektivitetin e ushtrimit të mandatit të tij. Këta faktorë lidhen me zhvillimet e shpejta teknologjike, rritjen e kompleksitetit të përpunimit të të dhënave personale, evolucionin e vazhdueshëm të kuadrit rregullator, si dhe me nivelin e zbatimit të legjislacionit nga autoritetet publike dhe subjektet private. Adresimi i këtyre sfidave kërkon përshtatje të vazhdueshme të kapaciteteve institucionale, bashkëpunim ndër-institucional dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Kërcënimet kryesore të identifikuara janë:

- Rritja e kompleksitetit të teknologjive digjitale, inteligjencës artificiale dhe përpunimit masiv të të dhënave, që krijon sfida të reja për mbrojtjen e të dhënave personale, transparencën dhe mbikëqyrjen rregullatore;
- Rritja e incidenteve të sigurisë kibernetike dhe e rreziqeve që lidhen me sigurinë e informacionit, me ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e të dhënave personale dhe besimin e publikut;
- Moszbatimi ose zbatimi jo i plotë i vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit, duke kufizuar efektivitetin e funksioneve mbikëqyrëse;
- Rritja e vazhdueshme e volumit dhe kompleksitetit të ankesave dhe çështjeve administrative, e lidhur me zgjerimin e përdorimit të teknologjive digjitale dhe zgjerimin e mandatit institucional;
- Ndryshimet e shpejta në legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare, të cilat kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të praktikave institucionale dhe zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale;
- Nivel i pamjaftueshëm i kulturës së transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale dhe respektimit të detyrimeve ligjore në një pjesë të autoriteteve publike dhe subjekteve private;
- Kufizimet buxhetore dhe rritja e kërkesave ndaj institucionit, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale.

Analiza SWOT tregon se Zyra e Komisionerit disponon një bazë të qëndrueshme institucionale, të mbështetur në kuadrin ligjor, pavarësinë institucionale, ekspertizën profesionale dhe bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar. Këta faktorë mbështesin forcimin e mëtejshëm të rolit të institucionit në garantimin e së drejtës për informim, mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat e hapura dhe transparencën në vendimmarrjen publike.

Në të njëjtën kohë, kërkohet zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve organizative, njerëzore, financiare dhe teknologjike për përballimin e sfidave të transformimit digjital, inteligjencës artificiale, përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimit të kuadrit ligjor për transparencën e lobimit.

Mundësitë që ofrojnë integrimi evropian, transformimi digjital dhe bashkëpunimi me partnerët, së bashku me adresimin e dobësive dhe kërcënimeve, orientojnë prioritetet dhe objektivat strategjike të periudhës 2026–2030.

V. Analiza e Situatës

Analiza e situatës paraqet gjendjen aktuale të fushave të përgjegjësisë së Zyrës së Komisionerit dhe identifikon zhvillimet kryesore që ndikojnë në ushtrimin e mandatit institucional. Ajo mbështetet në analizën e kuadrit ligjor dhe institucional, përvojën e institucionit në ushtrimin e funksioneve të tij, rezultatet e monitorimeve dhe hetimeve administrative, raportet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe zhvillimet që lidhen me procesin e integritetit evropian, transformimin digjital dhe zgjerimin e mandatit të Komisionerit.

Gjatë viteve të fundit janë shënuar zhvillime të rëndësishme në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e të drejtës për informim, mbrojtjes së të dhënave personale, të dhënave të hapura, konsultimit publik dhe transparencës së veprimtarisë së lobimit. Megjithatë, zbatimi efektiv i legjislacionit, rritja e kapaciteteve institucionale, zhvillimet teknologjike dhe pritshmëritë në rritje të qytetarëve vazhdojnë të paraqesin sfida që kërkojnë një qasje strategjike dhe të koordinuar.

Në këtë kontekst, analiza e situatës synon të evidentojë progresin e arritur, sfidat ekzistuese dhe fushat prioritare ku do të përqendrohen objektivat strategjike të Zyrës së Komisionerit për periudhën 2026 – 2030.

5.1 Situata aktuale në fushën e të drejtës për informim

E drejta për informim në Shqipëri ka njohur zhvillime të rëndësishme gjatë viteve të fundit, si rezultat i konsolidimit të kuadrit ligjor, forcimit të rolit mbikëqyrës të Komisionerit dhe rritjes graduale të kulturës së transparencës në administratën publike. Ndryshimet ligjore të viteve të fundit, ratifikimi i Konventës 205 e Këshillit të Evropës), zhvillimi i legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe përmirësimi i mekanizmave të transparencës proaktive dhe konsultimit publik, kanë zgjeruar standardet që autoritetet publike duhet të zbatojnë për garantimin e aksesit në informacion dhe rritjen e transparencës së vendimmarrjes publike.

Monitorimet e viteve të fundit evidentojnë një përmirësim të përgjithshëm të nivelit të transparencës proaktive dhe të respektimit të detyrimeve ligjore nga autoritetet publike, megjithëse niveli i zbatimit mbetet i pabarabartë ndërmjet institucioneve. Gjatë vitit 2025 u monitoruan 367 autoritete publike, krahasuar me 355 në vitin 2024; 357 autoritete kishin publikuar Programin e Transparencës, të gjitha kishin caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe 348 kishin publikuar Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve.

Indeksi i Transparencës Proaktive evidenton një trend pozitiv në publikimin proaktiv të informacionit dhe konsolidimin gradual të Programit të Transparencës si instrument i mirëqeverisjes. Monitorimet e kryera në mënyrë të vazhdueshme gjatë viteve të fundit tregojnë një rritje të numrit të autoriteteve me nivel të lartë transparence, megjithëse mbeten dallime në nivelin e zbatimit ndërmjet institucioneve.

Një zhvillim me rëndësi strategjike ishte edhe miratimi gjatë vitit 2025 i modeleve të reja të Programeve të Transparencës për autoritetet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Modelet e reja pasqyrojnë ndryshimet më të fundit ligjore, përfshirë kërkesat që burojnë nga Konventa nr. 205 e Këshillit të Evropës dhe procesi i integritetit evropian, duke zgjeruar kategoritë e informacionit që duhet të publikohen në mënyrë proaktive dhe duke forcuar transparencën e procesit të vendimmarrjes publike.

Megjithëse është shënuar progres, niveli i zbatimit të legjislacionit mbetet i pabarabartë ndërmjet autoriteteve publike. Sfidat lidhen me kapacitetet administrative dhe organizative, ndryshimin e koordinatorëve, përditësimin jo të rregullt të faqeve zyrtare, zbatimin jo të njëtrajtshëm të detyrimeve për transparencën proaktive dhe kapacitetet teknologjike. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025 evidenton gjithashtu nevojën që autoritetet publike të rrisin përputhshmërinë me

kërkesat e transparencës dhe përgjegjshmërinë ndaj kërkesave për informacion. Këto sfida kërkojnë zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve, monitorim të bazuar në evidencë dhe forcim të mekanizmave të llogaridhënies.

Në të njëjtën kohë, rritja e kërkesave të qytetarëve për transparencë, zhvillimi i shërbimeve digjitale, zbatimi i legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe procesi i integritetit evropian, po rrisin pritshmëritë ndaj rolit të Zyrës së Komisionerit si autoritet mbikëqyrës, rregullator dhe këshillues. Këto zhvillime kërkojnë jo vetëm forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe zbatimit të ligjit, por edhe zhvillimin e instrumenteve të reja të monitorimit, analizës së të dhënave, edukimit të autoriteteve publike dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve.

Për periudhën 2026 – 2030, sfida kryesore qëndron në garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm dhe efektiv të standardeve ligjore nga autoritetet publike. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit do të synojë forcimin e transparencës proaktive, përmirësimin e trajtimit të kërkesave për informacion, zhvillimin e mekanizmave modernë të monitorimit dhe vlerësimit të performancës, si dhe kontributin, brenda kompetencave ligjore, në përmirësimin e cilësisë së konsultimit publik.

5.2 Situata aktuale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale përbën një nga të drejtat themelore të individit dhe një element thelbësor për garantimin e besimit të qytetarëve në administratën publike dhe ekonominë digjitale. Gjatë viteve të fundit, kjo fushë ka njohur zhvillime të rëndësishme ligjore dhe institucionale, të cilat kanë forcuar standardet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kanë zgjeruar përgjegjësitë e kontrolluesëve publikë dhe privatë në përpunimin e të dhënave personale. Zhvillimi më i rëndësishëm ishte miratimi i ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i harmonizuar me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushëduke krijuar një kuadër të ri për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe forcimin e rolit të Zyrës së Komisionerit si autoritet mbikëqyrës.

Zbatimi i kuadrit të ri ligjor ka rritur ndjeshëm kompleksitetin e funksioneve të Zyrës së Komisionerit. Krahas ushtrimit të kompetencave mbikëqyrëse, institucioni është angazhuar në hartimin e akteve nënligjore, ofrimin e udhëzimeve, zhvillimin e aktiviteteve trajnuese dhe bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe partnerët ndërkombëtarë, me synim harmonizimin e praktikave shqiptare me standardet evropiane. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2025 vlerëson kuadrin e ri ligjor, por kërkon zbatim efektiv, forcim të kapaciteteve administrative e buxhetore të institucionit si dhe rritje të ndërgjegjësimit publik e të kapaciteteve parandaluese të institucioneve publike.

Në të njëjtën kohë, transformimi digjital i administratës publike, zgjerimi i përdorimit të shërbimeve elektronike, rritja e përpunimit të të dhënave në shkallë të gjerë dhe zhvillimi i inteligjencës artificiale po krijojnë sfida të reja për mbrojtjen e të dhënave personale. Përdorimi gjithnjë e më i gjerë i sistemeve të automatizuara të vendimmarrjes, shkëmbimi ndërkufitar i të dhënave dhe rritja e incidenteve të sigurisë kibernetike kërkojnë një qasje të bazuar në menaxhimin e rrezikut, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Analiza e situatës tregon se, megjithëse niveli i ndërgjegjësimit mbi mbrojtjen e të dhënave personale është përmirësuar, zbatimi praktik i legjislacionit mbetet i pabarabartë ndërmjet sektorëve. Hyrja në fuqi e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale ka sjellë sfida tranzitore për kontrolluesit, të cilët kërkojnë përshtatje të praktikave, investime në sigurinë e informacionit dhe forcim të rolit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave. Këto sfida lidhen jo vetëm me zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, por edhe me nevojën për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe organizative të kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave.

Në të njëjtën kohë, procesi i integritetit evropian, bashkëpunimi me strukturat e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, si dhe pjesëmarrja aktive e Zyrës së Komisionerit në rrjetet ndërkombëtare të autoriteteve mbikëqyrëse, krijojnë mundësi të rëndësishme për harmonizimin e praktikave

kombëtare me standardet evropiane dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale. Çështje si inteligjenca artificiale, qeverisja e të dhënave, transferimet ndërkombëtare të të dhënave dhe mbrojtja e privatësisë në mjedisin digjital do të vijojnë të jenë ndër prioritetet kryesore të veprimtarisë së Komisionerit gjatë viteve në vijim.

Për periudhën 2026 – 2030, sfida kryesore nuk qëndron vetëm në zbatimin efektiv të kuadrit të ri ligjor, por edhe në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të mbrojtjes së të dhënave personale në të gjithë sektorët e administratës publike dhe ekonomisë. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit do të synojë forcimin e funksioneve mbikëqyrëse, zhvillimin e kapaciteteve profesionale, promovimin e një qasjeje të bazuar në rrezik dhe rritjen e ndërgjegjësimit të kontrolluesëve publike, subjekteve private dhe qytetarëve, në përputhje me standardet evropiane dhe zhvillimet e shoqërisë digjitale.

5.3 Zgjerimi i mandatit institucional

Gjatë viteve të fundit, mandati i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është zgjeruar ndjeshëm, duke reflektuar zhvillimet ligjore, institucionale dhe teknologjike që karakterizojnë qeverisjen moderne. Nga një autoritet mbikëqyrës me përgjegjësi kryesisht në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, Komisioneri po konsolidohet si një autoritet me rol gjithnjë e më të gjerë në promovimin e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe qeverisjes së hapur.

Përveç funksioneve tradicionale në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, mandati i institucionit përfshin kompetenca për shqyrtimin e ankesave në fushën e njoftimit dhe konsultimit publik, funksione mbikëqyrëse e promovuese për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe promovimin e transparencës proaktive si standard të qeverisjes së mirë. Këto funksione kanë zgjeruar fushën e veprimit të institucionit dhe rolin e tij në mbështetjen e administratës publike për zbatimin e standardeve të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare.

Një zhvillim me rëndësi të veçantë është miratimi i ligjit nr. 12/2026 "Për lobimin në Republikën e Shqipërisë", i cili i ngarkon Komisionerit funksione të reja në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislationit, administrimin e Regjistratës së Lobimit, , shqyrtimin e shkeljeve administrative dhe promovimin e transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike. Ky zhvillim shënon zgjerimin më të rëndësishëm të mandatit institucional që prej krijimit të institucionit dhe e pozicionon Komisionerin si një aktor kyç në forcimin e integritetit publik dhe besimit të qytetarëve ndaj institucioneve.

Zgjerimi i mandatit institucional shoqërohet me rritjen e përgjegjësi mbikëqyrëse, rregullatore, këshilluese dhe ndërgjegjësuere të Komisionerit. Në të njëjtën kohë, ai kërkon zhvillimin e kapaciteteve të reja organizative dhe profesionale, forcimin e koordinimit ndërinstitucional, modernizimin e proceseve të punës dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, që mbështesin ushtrimin efektiv të funksioneve të reja.

Në këtë kontekst, zgjerimi i mandatit nuk duhet të kuptohet vetëm si shtim i kompetencave ligjore, por si transformim i rolit institucional të Zyrës së Komisionerit.

Për periudhën 2026 – 2030, institucioni synon të konsolidohet si autoriteti kombëtar lider në promovimin e transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale, qeverisjes së hapur dhe integritetit në vendimmarrjen publike, duke garantuar zbatimin e standardeve kombëtare dhe evropiane në të gjitha fushat e përgjegjësisë së tij.

5.4 Marrëdhëniet institucionale

Përmbushja efektive e mandatit të Komisionerit kërkon bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të strukturuar me institucionet publike, subjektet private, , shoqërinë civile, akademinë, median dhe partnerët ndërkombëtarë. Për shkak të natyrës ndërsektoriale të funksioneve të tij, Komisioneri

ushtron një rol koordinues, këshillues dhe mbikëqyrës në raport me një gamë të gjerë institucionesh dhe aktorësh, me qëllim garantimin e transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale, qeverisjes së hapur dhe integritetit në vendimmarrjen publike.

Bashkëpunimi me autoritetet publike përbën bazën e ushtrimit të funksioneve të Komisionerit dhe zhvillohet nëpërmjet monitorimit të zbatimit të legjislacionit, trajtimit të ankesave administrative, zhvillimit të hetimeve dhe inspektimeve, si dhe ofrimit të asistencës teknike dhe metodologjike. Komisioneri bashkëpunon gjithashtu me Kuvendin e Shqipërisë dhe institucionet e tjera kushtetuese në procesin e hartimit dhe përmirësimit të legjislacionit në fushat e mandatit të tij. Dialogu institucional dhe qasja këshilluese përbëjnë elemente të rëndësishme për rritjen e nivelit të pajtueshmërisë me legjislacionin dhe përmirësimin e praktikave administrative.

Shoqëria civile, media dhe komuniteti akademik përbëjnë partnerë të rëndësishëm në promovimin e transparencës, mbrojtjen e të drejtave të individit, rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe identifikimin e problematikave që kërkojnë ndërhyrje institucionale. Bashkëpunimi me këta aktorë kontribuon në zhvillimin e politikave më gjithëpërfshirëse dhe në forcimin e kulturës së transparencës dhe llogaridhënies.

Komisioneri zhvillon gjithashtu bashkëpunim të ngushtë me autoritetet homologe dhe organizatat ndërkombëtare, duke marrë pjesë aktive në rrjetet profesionale evropiane dhe ndërkombëtare. Ky bashkëpunim mundëson shkëmbimin e praktikave më të mira, harmonizimin me standardet ndërkombëtare, zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe koordinimin në trajtimin e sfidave të përbashkëta që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën për informim, qeverisjen e hapur dhe zhvillimet teknologjike.

Në kushtet e zgjerimit të mandatit institucional dhe kompleksitetit në rritje të sfidave që lidhen me transformimin digjital, inteligjencën artificiale dhe transparencën e vendimmarrjes publike, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional do të mbetet një nga faktorët kyç për realizimin e objektivave strategjikë të Komisionerit gjatë periudhës 2026 – 2030. Në këtë drejtim, institucioni do të synojë zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm të koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe zhvillimit të kapaciteteve, në funksion të zbatimit efektiv të legjislacionit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

5.5 Sfidat strategjike për periudhën 2026 – 2030

Analiza e situatës evidenton se Zyra e Komisionerit vepron në një mjedis institucional, ligjor dhe teknologjik në zhvillim të vazhdueshëm, ku zgjerimi i mandatit, procesi i integritetit evropian dhe transformimi digjital kërkojnë përshtatje të vazhdueshme të kapaciteteve institucionale. Në këtë kontekst, Strategjia 2026 – 2030 synon të adresojë sfidat kryesore që ndikojnë në realizimin efektiv të mandatit të Komisionerit dhe në garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve.

Sfidat strategjike për periudhën 2026 – 2030 janë:

- Forcimi i zbatimit efektiv të legjislacionit, duke rritur nivelin e pajtueshmërisë së autoriteteve publike dhe subjekteve private me detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fushën e të drejtës për informim, mbrojtjes së të dhënave personale, konsultimit publik, të dhënave të hapura dhe transparencës së veprimtarisë së lobimit;
- Përshtatja e institucionit ndaj zgjerimit të mandatit nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve organizative, profesionale dhe teknologjike, me qëllim ushtrimin efektiv të funksioneve të reja dhe rritjen e efektivitetit institucional;
- Përballimi i sfidave që lidhen me transformimin digjital dhe zhvillimin e inteligjencës artificiale, duke garantuar një balancë ndërmjet inovacionit, transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale dhe respektimit të të drejtave themelore;

- Forcimi i transparencës dhe qeverisjes së hapur përmes promovimit të transparencës proaktive, konsultimit publik, ripërdorimit të informacionit të sektorit publik dhe zhvillimit të politikave për të dhënat e hapura;
- Rritja e efektivitetit të funksioneve mbikëqyrëse dhe këshilluese nëpërmjet forcimit të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit, përdorimit të analizës së bazuar në evidencë, indikatorëve të performancës dhe përmirësimit të proceseve vendimmarrëse;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale nëpërmjet investimit në burimet njerëzore, zhvillimit të vazhdueshëm profesional të stafit, përmirësimit të proceseve institucionale dhe fuqizimit të infrastrukturës teknologjike;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar me institucionet publike, pushtetin vendor, sistemin e drejtësisë, shoqërinë civile, akademinë, median dhe partnerët ndërkombëtarë, me synim harmonizimin e praktikave kombëtare me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe besimit të publikut, duke promovuar një kulturë të transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale, integritetit dhe llogaridhënies, si dhe duke fuqizuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre.

Adresimi i këtyre sfidave do të orientojë prioritetet dhe objektivat strategjike të Zyrës së Komisionerit për periudhën 2026 – 2030, me synimin për të konsoliduar institucionin si një autoritet të pavarur, efektiv dhe të besueshëm në garantimin e transparencës, mbrojtjes së të dhënave personale, qeverisjes së hapur dhe integritetit në vendimmarrjen publike.

VI. Objektivat Strategjikë

6.1 Objektivi Strategjik 1: Forcimi i transparencës dhe garantimi efektiv i së drejtës për informim

Qëllimi strategjik

Të garantohet ushtrimi efektiv i së drejtës për informim nëpërmjet forcimit të transparencës së autoriteteve publike, përmirësimit të zbatimit të legjislacionit, zhvillimit të mekanizmave të monitorimit dhe rritjes së llogaridhënies, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Përshkrimi i objektivit

Ky objektivi synon konsolidimin e rolit të Zyrës së Komisionerit si autoriteti kombëtar përgjegjës për garantimin e së drejtës për informim dhe promovimin e transparencës në administratën publike. Gjatë periudhës 2026 – 2030, fokusi do të jetë në forcimin e zbatimit të legjislacionit nga autoritetet publike, rritjen e cilësisë së transparencës proaktive, përmirësimin e Programeve të Transparencës dhe Regjistrat të Kërkesave dhe Përgjigjeve, si dhe zhvillimin e mekanizmave më efektivë të monitorimit dhe vlerësimit të bazuar në evidencë.

Në përputhje me parimet e qeverisjes së hapur, objektivi synon të nxisë publikimin proaktiv të informacionit, rritjen e aksesueshmërisë së dokumenteve publike dhe përmirësimin e cilësisë së informacionit të publikuar nga autoritetet publike. Në të njëjtën kohë, Zyra e Komisionerit do të vijojë të ushtrojë funksionet e saj mbikëqyrëse, rregullatore, këshilluese dhe ndërgjegjësuere, duke kombinuar monitorimin sistematik me ofrimin e udhëzimeve metodologjike dhe mbështetjen për zhvillimin e kapaciteteve të administratës publike.

Realizimi i këtij objektivi do të kontribuojë në forcimin e transparencës institucionale, rritjen e llogaridhënies së autoriteteve publike dhe fuqizimin e qytetarëve në ushtrimin efektiv të së drejtës për informim.

Prioritetet strategjike

- Forcimi i monitorimit të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe transparencën proaktive;
- Përmirësimi dhe zhvillimi i Programit të Transparencës, duke mbështetur zhvillimin e instrumenteve digjitale për publikimin proaktiv të informacionit;
- Zhvillimi i metodologjive dhe instrumenteve të avancuara për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, duke kombinuar monitorimin dokumentar, hetimet administrative dhe verifikimet në terren, si dhe përmirësimin e instrumenteve ekzistuese të vlerësimit të transparencës;
- Përmirësimi i mekanizmave për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit;
- Forcimi i funksionit mbikëqyrës nëpërmjet monitorimeve dhe hetimeve administrative, në përputhje me kompetencat ligjore të Komisionerit;
- Hartimi dhe publikimi i raporteve tematike mbi zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve publike për zbatimin e standardeve të transparencës.

Rezultatet e pritshme

- Rritje e nivelit të pajtueshmërisë së autoriteteve publike me detyrimet ligjore në fushën e të drejtës për informim;
- Përmirësim i cilësisë dhe aksesueshmërisë së transparencës proaktive;

- Forcimi i efektivitetit të funksioneve mbikëqyrëse dhe këshilluese të Komisionerit;
- Rritje e kapaciteteve të autoriteteve publike për zbatimin e standardeve të transparencës;
- Rritje e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike dhe ushtrim më efektiv i së drejtës për informim.

6.2 Objektivi Strategjik 2 – Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në shoqërinë digjitale

Qëllimi strategjik

Të garantohet mbrojtja efektive e të dhënave personale dhe respektimi i të drejtave të individit nëpërmjet forcimit të mbikëqyrjes, rritjes së nivelit të pajtueshmërisë me legjislacionin, zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe promovimit të një kulture të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Përshkrimi i objektivit

Ky objektivi synon konsolidimin e rolit të Zyrës së Komisionerit si autoriteti kombëtar mbikëqyrës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në një kontekst të karakterizuar nga transformimi digjital, zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe përdorimi gjithnjë e më i gjerë i teknologjive që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale.

Gjatë periudhës 2026 – 2030, Zyra e Komisionerit do të fokusohet në forcimin e zbatimit të legjislacionit nga kontrolluesit publikë dhe privatë, rritjen e efektivitetit të funksioneve mbikëqyrëse dhe këshilluese, promovimin e praktikave të mira për përpunimin e ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave. Në këtë kuadër, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe vlerësimit të efektivitetit të kuadrit nënligjor në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim identifikimin e nevojave për përditësimin, harmonizimin dhe përmirësimin e tij në përputhje me zhvillimet ligjore, teknologjike dhe standardet evropiane.

Në të njëjtën kohë, objektivi synon të promovojë një qasje të bazuar në menaxhimin e rrezikut dhe parimin e përgjegjshmërisë, duke nxitur zbatimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale në të gjitha fazat e përpunimit të tyre. Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet sfidave që lidhen me transformimin digjital, përdorimin e inteligjencës artificiale, sigurinë e informacionit, transferimet ndërkombëtare të të dhënave personale dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe kategorive të tjera që kërkojnë mbrojtje të veçantë.

Realizimi i këtij objektivi do të kontribuojë në forcimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike dhe subjekteve private në rritjen e sigurisë juridike dhe në garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me standardet evropiane.

Prioritetet strategjike

- Forcimi i mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publikë dhe privatë;
- Përmirësimi i mekanizmave për monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit;
- Forcimi i funksionit mbikëqyrës nëpërmjet monitorimeve dhe hetimeve administrative, në përputhje me kompetencat ligjore të Komisionerit;
- Vlerësimi i efektivitetit të akteve nënligjore dhe zhvillimi i kuadrit metodologjik për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Hartimi dhe përditësimi i akteve nënligjore dhe udhëzuesëve për zbatimin e legjislacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare;

- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të, kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave personale, si dhe aktorëve të tjerë relevantë;
- Promovimi i praktikave të sigurta dhe të përgjegjshme në përpunimin e të dhënave personale, me fokus në teknologjitë e reja, inteligjencën artificiale, sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe kategorive të tjera vulnerabël;
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi të drejtat që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe mënyrat e ushtrimit të tyre.

Rezultatet e pritshme

- Rritje e nivelit të pajtueshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Forcimi i efektivitetit të funksioneve mbikëqyrëse dhe këshilluese të Komisionerit;
- Përmirësim i kuadrit metodologjik dhe nënligjor për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Përmirësim i praktikave të përpunimit të të dhënave personale nga autoritetet publike dhe subjektet private;
- Rritje e kapaciteteve profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Rritje e ndërgjegjësimit të publikut dhe e besimit në mekanizmat për mbrojtjen e privatësisë.

6.3 Objektivi Strategjik 3 – Forcimi i qeverisjes së hapur përmes konsultimit publik dhe të dhënave të hapura

Qëllimi strategjik

Të forcohet qeverisja e hapur nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të Komisionerit për njoftimin dhe konsultimin publik dhe mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, duke kontribuar në rritjen e transparencës së vendimmarrjes, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe aksesit në informacion me interes publik.

Përshkrimi i objektivit

Ky objektivi synon forcimin e rolit të Zyrës së Komisionerit në promovimin e qeverisjes së hapur përmes shqyrtimit të ankesave dhe analizës së praktikave në fushën e njoftimit dhe konsultimit publik, si dhe përmes mbikëqyrjes dhe promovimit të zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Në fushën e konsultimit publik, prioritet do të jetë ushtrimi efektiv i kompetencave për shqyrtimin e ankesave, analizimi i problematikave të përsëritura dhe formulimi i rekomandimeve për rritjen e cilësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes në proceset e konsultimit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENKP). Në fushën e të dhënave të hapura, Zyra e Komisionerit do të promovojë zbatimin efektiv të ligjit nr.33/2022, duke nxitur publikimin e të dhënave në formate të hapura dhe të lexueshme nga makina, përditësimin sistematik të tyre, publikimin e grupeve të të dhënave me vlerë të lartë dhe rritjen e ripërdorimit të informacionit të sektorit publik nga qytetarët, bizneset, komuniteti akademik, media dhe organizatat e shoqërisë civile.

Nëpërmjet monitorimit, orientimit metodologjik, zhvillimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, Zyra e Komisionerit do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së politikëbërjes publike, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe në zhvillimin e një administrate publike më të hapur, më pjesëmarrëse dhe më të orientuar drejt qytetarit.

Prioritetet strategjike

- Forcimi i mekanizmave për shqyrtimin e ankesave, analizën e praktikave dhe formulimin e rekomandimeve në fushën e njoftimit dhe konsultimit publik;
- Përmirësimi i cilësisë dhe transparencës së proceseve të konsultimit publik, duke nxitur pjesëmarrjen efektive të qytetarëve dhe aktorëve të interesit;
- Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse për përmirësimin e përdorimit dhe funksionimit të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENKP);
- Promovimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik;
- Nxitja e publikimit të grupeve të të dhënave me vlerë të lartë, në formate të hapura dhe të lexueshme nga makina, në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane;
- Zhvillimi i udhëzimeve metodologjike dhe ngritja e kapaciteteve të autoriteteve publike në fushën e konsultimit publik dhe të dhënave të hapura;
- Promovimi i ripërdorimit të informacionit të sektorit publik nga qytetarët, bizneset, komuniteti akademik, media dhe organizatat e shoqërisë civile.

Rezultatet e pritshme

- Rritje e nivelit të zbatimit të legjislacionit për konsultimin publik dhe të dhënat e hapura, në përputhje me kompetencat e Komisionerit;
- Përmirësim i cilësisë së proceseve të konsultimit publik dhe rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Rritje e numrit dhe cilësisë së grupeve të të dhënave të publikuara në formate të hapura dhe të ripërdorshme;
- Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve publike për zbatimin e standardeve të qeverisjes së hapur;
- Rritje e përdorimit dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik;
- Përmirësim i transparencës, llogaridhënies dhe besimit të publikut ndaj institucioneve.

6.4 Objektivi Strategjik 4 – Zbatimi efektiv i mandatit të Komisionerit në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit

Qëllimi strategjik

Të sigurohet zbatimi efektiv i legjislacionit për transparencën e veprimtarisë së lobimit nëpërmjet krijimit të mekanizmave të mbikëqyrjes, regjistrimit, monitorimit dhe orientimit metodologjik, me qëllim forcimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike.

Përshkrimi i objektivit

Ky objektivi synon konsolidimin e rolit të Komisionerit si autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për transparencën e veprimtarisë së lobimit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në ligjin nr. 12/2026 "Për lobimin në Republikën e Shqipërisë".

Gjatë periudhës 2026 – 2030, prioritet do të jetë krijimi dhe konsolidimi i kuadrit institucional, organizativ dhe metodologjik të nevojshëm për ushtrimin e këtij mandati të ri. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit do të miratojë aktet nënligjore brenda afateve ligjore, do të zhvillojë procedurat për regjistrimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së lobimit dhe do të krijojë Regjistrin e Lobimit, si instrument kyç për transparencën dhe aksesin e publikut në informacion.

Njëkohësisht, objektivi synon zhvillimin e kapaciteteve të zyrtarëve publikë, lobistëve dhe përfituesve të lobimit për zbatimin korrekt të legjislacionit, si dhe promovimin e një kulture integriteti, transparence dhe llogaridhënieje në marrëdhëniet ndërmjet aktorëve publikë dhe privatë.

Realizimi i këtij objektivi do të kontribuojë në rritjen e gjurmueshmërisë së ndërveprimeve të lobimit, uljen e rrezikut të ndikimit të papërshtatshëm, forcimin e besimit të publikut në proceset vendimmarrëse dhe përafrimin e praktikave kombëtare me standardet ndërkombëtare në fushën e transparencës së lobimit.

Prioritetet strategjike

- Hartimi, miratimi dhe përditësimi i akteve nënligjore, për zbatimin efektiv të legjislacionit për transparencën e veprimtarisë së lobimit;
- Krijimi, administrimi dhe zhvillimi i Regjistrit të Lobimit, si instrument për garantimin e transparencës dhe aksesit publik në informacion;
- Zhvillimi i mekanizmave për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të detyrimeve ligjore nga lobistët, përfituesit e lobimit dhe zyrtarët publikë;
- Hartimi i udhëzuesëve metodologjike dhe standardeve për zbatimin e legjislacionit në fushën e lobimit;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të zyrtarëve publikë, lobistëve dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në zbatimin e ligjit;
- Promovimi i transparencës dhe ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e transparencës së veprimtarisë së lobimit dhe integritetit në vendimmarrjen publike.

Rezultatet e pritshme

- Kuadër rregullator dhe institucional funksional për zbatimin e legjislacionit për lobimin;
- Regjistër i Lobimit funksional dhe i aksesueshëm për publikun;
- Rritje e nivelit të pajtueshmërisë me detyrimet ligjore nga subjektet e përfshira në veprimtarinë e lobimit;
- Forcim i kapaciteteve profesionale për zbatimin e legjislacionit;
- Rritje e transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike;
- Rritje e besimit të publikut në mekanizmat e transparencës dhe llogaridhënies.

6.5 Objektivi Strategjik 5 – Forcimi i efektivitetit institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve organizative

Qëllimi strategjik

Të rritet efektiviteti institucional i Zyrës së Komisionerit nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve organizative, profesionale dhe teknologjike, përmirësimit të proceseve të punës, konsolidimit të funksioneve të reja institucionale dhe forcimit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Përshkrimi i objektivit

Ky objektivi synon forcimin e kapaciteteve institucionale të Zyrës së Komisionerit, me qëllim rritjen e efektivitetit në ushtrimin e mandateve ligjore dhe përmirësimin e cilësisë së funksioneve mbikëqyrëse, rregullatore, këshilluese dhe ndërgjegjësuëse. Në kushtet e zgjerimit të mandatit institucional dhe zhvillimeve të shpejta teknologjike, institucioni do të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore, përmirësimin e proceseve organizative dhe modernizimin e sistemeve të informacionit që mbështesin veprimtarinë e tij.

Objektivi përfshin gjithashtu zhvillimin e mekanizmave për monitorimin e performancës institucionale, përmirësimin e menaxhimit të rasteve dhe ndjekjes së zbatimit të vendimeve e rekomandimeve të Komisionerit, si dhe forcimin e bashkëpunimit me autoritetet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe rrjetet profesionale. Nëpërmjet këtyre masave synohet ndërtimi i një institucioni modern, efikas dhe të aftë për t'iu përgjigjur sfidave që lidhen me transparencën, mbrojtjen e të dhënave personale, qeverisjen e hapur dhe transparencën e veprimtarisë së lobimit.

Prioritetet strategjike

- Zhvillimi i kapaciteteve organizative dhe profesionale në përputhje me zgjerimin e mandatit institucional;
- Përmirësimi i proceseve të punës, sistemeve të menaxhimit të rasteve dhe infrastrukturës teknologjike;
- Zhvillimi i mekanizmave për monitorimin e performancës institucionale dhe ndjekjen e zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve;
- Investimi në zhvillimin profesional të stafit dhe specializimin në fushat e reja të mandatit;
- Forcimi i bashkëpunimit me autoritetet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe rrjetet profesionale, për shkëmbimin e ekspertizës dhe zhvillimin e kapaciteteve institucionale;
- Pjesëmarrja aktive në rrjetet dhe mekanizmat ndërkombëtarë, duke promovuar rolin e Komisionerit dhe harmonizimin e praktikave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme

- Strukturë organizative dhe kapacitete institucionale të përshtatura me zgjerimin e mandatit të Komisionerit;
- Përmirësim i proceseve organizative dhe zhvillim i sistemeve të informacionit që mbështesin veprimtarinë institucionale;
- Përmirësim i monitorimit të performancës institucionale dhe i mekanizmave për ndjekjen e zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit;
- Rritje e nivelit të ekspertizës profesionale dhe specializimit të stafit në fushat e mandatit të institucionit;
- Bashkëpunim i zgjeruar me autoritetet publike, partnerët ndërkombëtarë dhe rrjetet profesionale, duke kontribuar në zhvillimin institucional dhe harmonizimin me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- Rritje e efektivitetit institucional dhe e cilësisë së ushtrimit të funksioneve të Komisionerit.

Objektivat strategjikë të përcaktuar në këtë kapitull përkthehen në masa konkrete në Aneksin I – Planin e Veprimit 2026 – 2027, ku përcaktohen rezultatet e pritshme, treguesit, strukturat përgjegjëse, afatet dhe burimet e financimit.

VII. Zbatimi dhe Monitorimi i Strategjisë

7.1 Zbatimi i Strategjisë

Zbatimi i Strategjisë 2026 – 2030 mbështetet në angazhimin e të gjitha strukturave të Komisionerit, koordinimin ndërmjet tyre dhe përdorimin racional të burimeve njerëzore, financiare dhe teknologjike. Përgjegjësia për koordinimin e përgjithshëm i takon Sekretarit të Përgjithshëm, me mbështetjen e Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Integritetit dhe të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

Strategjia zbatohet nëpërmjet planeve të veprimit të miratuara nga Komisioneri. Plani i parë mbulon periudhën 2026 – 2027. Plani i Veprimit 2028 – 2030 do të hartohet mbi bazën e rezultateve të monitorimit, zhvillimeve ligjore dhe prioritetëve institucionale dhe do të miratohet jo më vonë se fundi i vitit 2027, për të shmangur boshllëkun në planifikimin operacional.

Masat e Strategjisë do të integrohen në planin vjetor të punës, në Programin Buxhetor Afatmesëm dhe, sipas rastit, në planet e prokurimit, zhvillimit të burimeve njerëzore dhe teknologjisë së informacionit. Rekomandimet vjetore të Kuvendit të Shqipërisë dhe detyrimet që burojnë nga procesi i integritetit evropian do të reflektohen në planifikimin operacional, kur lidhen me objektivat e Strategjisë.

Zbatimi do të mbështetet edhe në bashkëpunimin me autoritetet publike, sektorin privat, shoqërinë civile, akademinë, autoritetet homologe dhe partnerët ndërkombëtarë, duke ruajtur përgjegjësinë institucionale të Komisionerit për rezultatet që varen nga kompetencat dhe burimet e tij.

7.2 Monitorimi, raportimi dhe rishikimi

Monitorimi është proces i vazhdueshëm dhe bazohet në masat, afatet dhe treguesit e Planit të Veprimit. Çdo strukturë përgjegjëse raporton çdo gjashtë muaj mbi progresin, evidencat verifikuese, problematikat dhe masat korrigjuese. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit konsolidon informacionin dhe e paraqet për shqyrtim te Sekretari i Përgjithshëm dhe GMS-ja.

Për çdo tregues që nuk ka një bazë matëse në momentin e miratimit të Strategjisë, struktura përgjegjëse përcakton bazën brenda vitit të parë të zbatimit dhe propozon për miratim synimin përkatës. Ndryshimi i treguesve ose i synimeve duhet të dokumentohet dhe të mos cenojë llogaridhënien për rezultatet e parashikuara.

Do të hartohen dy raporte të brendshme monitorimi në vit dhe një raport vjetor i konsoliduar. Përmbledhja e rezultateve do të reflektohet në Raportin Vjetor të veprimit të Komisionerit dhe në raportimet për Kuvendin e Shqipërisë. Kur është e përshtatshme dhe pa cenuar informacionin e mbrojtur, rezultatet kryesore do të publikohen për të forcuar transparencën institucionale.

Një rishikim afatmesëm i Strategjisë do të kryhet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2028. Rishikimi do të vlerësojë progresin, realizueshmërinë e objektivave, efektivitetin e masave dhe nevojën për ndryshime që burojnë nga kuadri ligjor, integrimi evropian, zhvillimet teknologjike ose kapacitetet institucionale. Çdo ndryshim miratohet me vendim të Komisionerit.

7.3 Burimet për zbatimin e Strategjisë

Zbatimi i Strategjisë do të mbështetet në burimet njerëzore, financiare dhe teknologjike të Komisionerit, të programuara në përputhje me legjislacionin në fuqi, Programin Buxhetor Afatmesëm dhe prioritetet institucionale.

Financimi do të sigurohet kryesisht nga buxheti i institucionit. Për masa që kërkojnë ekspertizë ose investime shtesë, Komisioneri do të synojë mbështetje teknike dhe financiare nga partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Përfshirja e një mase në Planin e Veprimit nuk nënkupton automatikisht

sigurimin e financimit të jashtëm; masat do të riplanifikohen kur financimi, prokurimi ose kapacitetet nuk e lejojnë realizimin në afatin fillestar, duke dokumentuar arsyet dhe masat korrigjuese.

Plani i Veprimit 2026 – 2027, i paraqitur në Aneksin I, është pjesë përbërëse e Strategjisë dhe përmban tregues, synime, burime verifikimi, strukturat përgjegjëse, afatet dhe burimet e financimit.

7.4 Menaxhimi i rreziqeve

Rreziqet kryesore për zbatimin e Strategjisë lidhen me kufizimet e burimeve njerëzore dhe buxhetore, vonesat në prokurime dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, varësinë nga bashkëpunimi i institucioneve të tjera, nivelin e pajtueshmërisë së subjekteve të mbikëqyrura dhe ndryshimet e shpejta ligjore e teknologjike.

GMS-ja do të mbajë dhe përditësojë një regjistër të rreziqeve, ku përcaktohen probabiliteti, ndikimi, struktura përgjegjëse dhe masat parandaluese ose korrigjuese. Rreziqet me ndikim të lartë dhe masat e ndërmarra do të përfshihen në raportet gjashtëmujore të monitorimit.

ANEKSI I

Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë 2026 – 2027

Shënim metodologjik: Kur mungon baza matëse, ajo krijohet brenda vitit të parë të zbatimit dhe synimi miratohet mbi bazën e të dhënave të verifikuara. Afatet dhe masat që varen nga prokurimi ose financimi i jashtëm rishikohen vetëm me arsyetim të dokumentuar në raportin e monitorimit.

Objektivi Strategjik 1: Forcimi i transparencës dhe garantimi efektiv i së drejtës për informim

Kodi	Prioriteti dhe masa/veprimtaria	Rezultati i pritshëm	Treguesi, synimi dhe burimi i verifikimit	Struktura përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati	Burimi i financimit
1.1	Forcimi i transparencës proaktive Masa/veprimtaria: Zbatimi i monitorimit vjetor të Programit të Transparencës, Regjistrin të Kërkesave dhe Përgjigjeve, caktimi të koordinatorëve dhe përdorimit të REKPD/portalit pyetshtet.al, sipas planit vjetor të monitorimit.	Rritje e qëndrueshme e përputhshmërisë së autoriteteve publike dhe transparencë proaktive më cilësore.	Baza 2025: 357/367 autoritete me Program Transparence (97,3%); 367/367 me koordinator (100%); 348/367 me Regjistër të Kërkesave dhe Përgjigjeve (94,8%). Synimi 2027: ≥98%, 100% dhe ≥97%, përkatësisht; 100% e autoriteteve të parashikuara në planin vjetor të monitoruara. Verifikimi: raportet vjetore dhe Indeksi i Transparencës.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit; Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës; mbështetje IT	T4 2026 / T4 2027	Buxheti i institucionit
1.2	Përmirësimi i metodologjisë së mbikëqyrjes Masa/veprimtaria: Hartimi, miratimi dhe pilotimi i metodologjisë së auditimit të transparencës proaktive, duke kombinuar analizën dokumentare, verifikimin praktik dhe, sipas rastit, verifikimin në terren; përditësimi i metodologjisë pas pilotimit.	Mbikëqyrje më e standardizuar, e thelluar dhe e bazuar në evidencë.	Metodologjia e miratuar; pilotim në të paktën 3 autoritete publike deri në T4 2026; raport pilotimi dhe version i përditësuar; zbatim në kampionin e përcaktuar për vitin 2027.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit; Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës	T4 2026 – T4 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
1.3	Forcimi i funksioneve mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse Masa/veprimtaria: Shqyrtimi i ankesave, zhvillimi i hetimeve administrative dhe monitorimeve tematike, si dhe ndjekja e zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit.	Trajtim më efikas i rasteve dhe rritje e zbatimit të vendimeve e rekomandimeve.	100% e ankesave të trajtuara brenda afateve ligjore ose me arsyetim të dokumentuar; numri i hetimeve/monitorimeve tematike; 100% e vendimeve dhe rekomandimeve me afat të përfunduar të verifikuara për ndjekje; raportim vjetor mbi kohën mesatare të trajtimit.	Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave; Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit	Vazhdimisht	Buxheti i institucionit
1.4	Vlerësimi i zbatimit të kuadrit ligjor Masa/veprimtaria: Kryerja e një vlerësimi institucional mbi zbatimin e ndryshimeve të ligjit për të drejtën e informimit dhe identifikimi i nevojave për përmirësime metodologjike, nënligjore ose ligjore.	Problematicat e zbatimit të evidentuara dhe masa përmirësuese të propozuara.	Raport vlerësimi i miratuar; analiza e të dhënave të ankesave, monitorimeve dhe jurisprudencës; rekomandime të klasifikuara sipas prioritetit dhe institucionit përgjegjës.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit	T4 2027	Buxheti i institucionit
1.5	Zhvillimi i kapaciteteve të autoriteteve publike Masa/veprimtaria: Hartimi dhe zbatimi, në bashkëpunim me ASPA-n, i një programi trajnimit për koordinatorët dhe punonjësit e autoriteteve publike mbi të drejtën për informim, transparencën proaktive dhe përdorimin e instrumenteve përkatëse.	Kapacitete profesionale më të qëndrueshme dhe praktika më të unifikuara.	Programi i miratuar; realizimi 100% i sesioneve të parashikuara në planin vjetor; numri i pjesëmarrësve; vlerësim para/pas trajnimit ose formular vlerësimi me të paktën 80% rezultate pozitive.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/ASPA	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
1.6	Promovimi i kulturës së transparencës Masa/veprimtaria: Hartimi dhe pilotimi i një programi ndërgjegjëses për të drejtën për informim dhe transparencën, në bashkëpunim me universitete dhe institucione të arsimit të lartë.	Rritje e njohurive praktike të studentëve mbi ushtrimin e së drejtës për informim.	Programi dhe materialet e hartuara; përfshirja e të paktën 3 institucioneve të arsimit të lartë deri në fund të vitit 2027; numri i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve; përmblledhje e vlerësimeve të pjesëmarrësve.	Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit; universitete partnere	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi

Objektivi Strategjik 2: Garantimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale në shoqërinë digjitale

Kodi	Prioriteti dhe masa/veprimtaria	Rezultati i pritshëm	Treguesi, synimi dhe burimi i verifikimit	Struktura përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati	Burimi i financimit
2.1	Forcimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik Masa/veprimtaria: Zbatimi i planeve vjetore të mbikëqyrjes së kontrolluesve dhe përpunuesve publikë e privatë, bazuar në analizën e rrezikut, problematikat e ankesave dhe prioritetet institucionale; ndjekja e rekomandimeve të lëna.	Rritje e pajtueshmërisë dhe fokus më i mirë i burimeve mbikëqyrëse.	Analiza vjetore e rrezikut e dokumentuar; ≥90% e veprimtarive të planifikuara të realizuara ose të riplanifikuara me arsyetim; numri i hetimeve dhe akteve; 100% e rekomandimeve me afat të përfunduar të përfshira në procesin e verifikimit.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe drejtoritë e saj	T4 2026 / T4 2027	Buxheti i institucionit
2.2	Vlerësimi i kuadrit nënligjor Masa/veprimtaria: Inventarizimi dhe vlerësimi i zbatimit dhe efektivitetit të akteve nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 124/2024, me qëllim identifikimin e nevojave për, harmonizim dhe plotësim.	Kuadër nënligjor koherent dhe i përshtatur me zhvillimet evropiane e teknologjike.	100% e akteve nënligjore të zbatueshme të inventarizuara dhe të vlerësuara; raport vlerësimi; propozime të prioritetizuara për ndryshim ose plotësim.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit	S2 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
2.3	Udhëzues sektorial për fusha me rrezik të lartë Masa/veprimtaria: Hartimi dhe publikimi i udhëzuesve sektorialë për zbatimin e legjislacionit, me fokus sektorët me risk të lartë dhe zhvillimet e reja teknologjike.	Praktika më të unifikuara dhe pajtueshmëri më e lartë në sektorët prioritarë.	Të paktën 3 udhëzues sektorialë të publikuar deri në fund të vitit 2027; konsultim me aktorët relevantë; materiale shpjeguese dhe evidencë e shpërndarjes/përdorimit.	Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave; Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
2.4	Zhvillimi i kapaciteteve të kontrolluesve dhe DPO-ve Masa/veprimtaria: Hartimi dhe zbatimi, në bashkëpunim me ASPA-n dhe aktorë sektorialë, i një programi të vazhdueshëm trajnimi dhe mbështetjeje metodologjike për administratën publike, nëpunësit e mbrojtjes së të dhënave dhe sektorët privatë prioritarë.	Rritje e kapaciteteve për zbatimin praktik të ligjit dhe parimit të përgjegjshmërisë.	Programi i miratuar; të paktën 4 sesione gjatë periudhës 2026 – 2027; numri i pjesëmarrësve sipas kategorisë; vlerësim i njohurive ose kënaqësisë me të paktën 80% rezultate pozitive.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale/ASPA/aktorë sektorialë	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
2.5	Teknologjitë e reja dhe siguria e të dhënave Masa/veprimtaria: Zhvillimi i veprimtarive tematike mbi inteligjencën artificiale, vendimmarrjen e automatizuar, vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, mbrojtja e të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar, menaxhimin e shkeljeve të sigurisë dhe transferimet ndërkombëtare.	Qasje më e qartë dhe më parandaluese ndaj rreziqeve të teknologjive të reja.	Të paktën 2 veprimtari tematike mbikëqyrëse ose analitike; të paktën 1 udhëzues, rekomandim ose raport publik; problematikat dhe masat e propozuara të dokumentuara.	Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave; Drejtoria e Ankesave dhe Harmonizimit	S2 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
2.6	Promovimi i kulturës së privatësisë Masa/veprimtaria: Hartimi dhe pilotimi i një programi ndërgjegjësues për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përdorimin e sigurt të teknologjive digjitale, me fokus fëmijët, të rinjtë dhe institucionet arsimore.	Rritje e ndërgjegjësimit dhe aftësi praktike për mbrojtjen e privatësisë.	Programi dhe materiale të përshtatshme sipas grupmoshës; përfshirja e të paktën 5 institucioneve arsimore; numri i aktiviteteve dhe pjesëmarrësve; vlerësim i shkurtër i përfitimit.	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; institucionet përgjegjëse të arsimit	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi

Objektivi Strategjik 3: Forcimi i qeverisjes së hapur përmes konsultimit publik dhe të dhënave të hapura

Kodi	Prioriteti dhe masa/veprimtaria	Rezultati i pritshëm	Treguesi, synimi dhe burimi i verifikimit	Struktura përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati	Burimi i financimit
3.1	Ushtrimi i kompetencave për konsultimin publik Masa/veprimtaria: Shqyrtimi i ankesave sipas ligjit nr. 146/2014 dhe hartimi i një analize vjetore mbi problematikat e evidentuara në proceset e konsultimit dhe përdorimin e RENKP-së, mbi bazën e ankesave, të dhënave publike dhe një kampioni të përcaktuar.	Mbrojtje administrative efektive dhe rekomandime të bazuara në evidencë për përmirësimin e konsultimit publik.	100% e ankesave të trajtuara brenda afateve ligjore ose me arsyetim të dokumentuar; analizë/raport vjetor; numri i rekomandimeve dhe ndjekja e tyre me institucionet përgjegjëse.	Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik; Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave	2026 – 2027	Buxheti i institucionit
3.2	Zhvillimi i kapaciteteve për konsultimin publik Masa/veprimtaria: Hartimi dhe zbatimi, në bashkëpunim me ASPA-n dhe institucionet përgjegjëse, i një programi trajnimi për standardet e konsultimit publik dhe përdorimin efektiv të RENKP-së.	Kapacitete më të mira të koordinatorëve dhe strukturave përgjegjëse.	Programi i miratuar; të paktën 3 sesione gjatë periudhës; numri i pjesëmarrësve; vlerësim i njohurive/kënaqësisë.	Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik/ASPA/institucioni administruar i RENKP-së	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
3.3	Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit për të dhënat e hapura Masa/veprimtaria: Monitorimi i një kampioni vjetor të organeve të sektorit publik mbi publikimin e listave të dokumenteve, formatet e hapura, përditësimin e të dhënave dhe përbushjen e detyrimeve të ligjit nr. 33/2022.	Përmirësim gradual i disponueshmërisë, cilësisë dhe ripërdorshmërisë së të dhënave.	Kampioni dhe metodologjia e miratuar çdo vit; bazë matëse e krijuar në vitin 2026; raport monitorimi 2026 dhe raport vijues 2027; numri i rekomandimeve dhe statusi i ndjekjes.	Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik	T4 2026 / T4 2027	Buxheti i institucionit
3.4	Udhëzime për publikimin dhe ripërdorimin Masa/veprimtaria: Hartimi ose përditësimi, në koordinim me institucionet përgjegjëse, i udhëzimeve për publikimin në formate të hapura e të lexueshme nga makina, metadata-t, përditësimin dhe grupet e të dhënave me vlerë të lartë.	Kërkesa më të qarta dhe praktika më të njëtrajtshme për organet e sektorit publik.	Të paktën 1 paketë e plotë udhëzuese e miratuar/publikuar; konsultim teknik me institucionet përgjegjëse; numri i autoriteteve të orientuara.	Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit	S2 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
3.5	Promovimi i ripërdorimit dhe pjesëmarrjes Masa/veprimtaria: Zhvillimi i aktiviteteve me universitete, OSHC, media, biznese dhe partnerë për të promovuar ripërdorimin e të dhënave të hapura dhe pjesëmarrjen e informuar në vendimarrje.	Rritje e përdorimit praktik të të dhënave dhe ndërgjegjësimin mbi qeverisjen e hapur.	Të paktën 3 aktivitete ose raste përdorimi të dokumentuara; numri dhe lloji i partnerëve/pjesëmarrësve; përmbledhje publike e rezultateve dhe rekomandimeve.	Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik; partnerë të jashtëm	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi

Objektivi Strategjik 4: Zbatimi efektiv i mandatit të Komisionerit në fushën e transparencës së veprimtarisë së lobimit

Kodi	Prioriteti dhe masa/veprimtaria	Rezultati i pritshëm	Treguesi, synimi dhe burimi i verifikimit	Struktura përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati	Burimi i financimit
4.1	Plotësimi i kuadrit rregullator Masa/veprimtaria: Hartimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore të ngarkuara Komisionerit nga neni 27 i ligjit nr. 12/2026, si dhe i udhëzimeve dhe formularëve të nevojshëm për zbatim.	Kuadër rregullator i plotë dhe i zbatueshëm brenda afatit ligjor.	100% e akteve nënligjore të deleguara me nenin 27 të hartuara dhe miratuara brenda afatit ligjor; udhëzimet dhe formularët e publikuar.	Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; struktura përgjegjëse për lobimin; strukturat e tjera përkatëse	Brenda afatit të nenit 27	Buxheti i institucionit
4.2	Ngritja e organizimit të brendshëm për mandatin e ri Masa/veprimtaria: Përcaktimi i strukturës përgjegjëse, roleve, flukseve të punës, procedurave të brendshme, nevojave për personel dhe planit fillestar të zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e ligjit.	Përgjegjësi të qarta dhe procese pune funksionale.	Akt i brendshëm i miratuar; hartë e proceseve dhe përgjegjësi; vlerësim i nevojave për kapacitete; procedura për regjistrim, verifikim, mbikëqyrje, ankesa dhe sanksione.	Sekretari i Përgjithshëm; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	T4 2026	Buxheti i institucionit
4.3	Krijimi dhe funksionalizimi i Regjistrit të Lobimit Masa/veprimtaria: Përcaktimi i kërkesave funksionale dhe të sigurisë, projektimi, prokurimi/zhvillimi, testimi dhe vënia në funksion e Regjistrit të Lobimit, me publikim të informacionit sipas ligjit dhe standardeve të aksesueshmërisë.	Regjistër elektronik funksional, i sigurt dhe i aksesueshëm për publikun.	Kërkesat funksionale e të sigurisë të miratuara; procedura e prokurimit/zhvillimit e përfunduar sipas planit; testim pranimit dhe procesverbal; regjistri funksional; disponueshmëria dhe incidentet e dokumentuara pas vënies në punë.	Struktura përgjegjëse për lobimin; sektori IT; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	2026 – 2027,	Partnerë zhvillimi/buxheti
4.4	Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit Masa/veprimtaria: Pas funksionalizimit të kuadrit dhe regjistrit, administrimi i aplikimeve dhe raportimeve, verifikimi i përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe zhvillimi i procedurave mbikëqyrëse e administrative.	Zbatim i njëtrajtshëm dhe rritje graduale e pajtueshmërisë së subjekteve të ligjit.	100% e aplikimeve të trajtuara brenda afateve ligjore; numri i subjekteve të regjistruara; numri i verifikimeve/procedurave; statusi i zbatimit të vendimeve dhe rekomandimeve; statistika vjetore të publikuara.	Struktura përgjegjëse për lobimin; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit	Nga funksionalizimi dhe vazhdimisht	Buxheti i institucionit
4.5	Zhvillimi i kapaciteteve dhe orientimi metodologjik Masa/veprimtaria: Hartimi i udhëzuesve, FAQ-ve dhe materialeve praktike, si dhe zhvillimi i trajnimeve për zyrtarët publikë, lobistët, përfituesit e lobimit dhe aktorët e tjerë relevantë.	Kuptim më i qartë i detyrimeve dhe zbatim më i njëtrajtshëm i ligjit.	Paketa udhëzuese e publikuar; të paktën 4 sesione gjatë periudhës; numri i pjesëmarrësve sipas kategorisë; pyetjet e shpeshta të përditësuara mbi bazën e praktikës.	Struktura përgjegjëse për lobimin; ASPA; partnerë zhvillimi	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
4.6	Raportimi dhe transparenca publike Masa/veprimtaria: Hartimi dhe paraqitja në Kuvend e raportit vjetor për zbatimin e ligjit, si dhe publikimi i të dhënave dhe analizave të kërkuara nga kuadri ligjor.	Llogaridhënie institucionale dhe informacion publik i rregullt mbi zbatimin e ligjit.	Raporti vjetor i paraqitur dhe publikuar brenda afatit ligjor; të dhënat kryesore të regjistrit dhe zbatimit, të publikuara në format të aksesueshëm; rekomandimet e raportit të ndjekura në planifikimin e vitit pasues.	Struktura përgjegjëse për lobimin; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; Kabineti	Çdo vit, sipas ligjit	Buxheti i institucionit

Objektivi Strategjik 5: Forcimi i efektivitetit institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve organizative

Kodi	Prioriteti dhe masa/veprimtaria	Rezultati i pritshëm	Treguesi, synimi dhe burimi i verifikimit	Struktura përgjegjëse/bashkëpunuese	Afati	Burimi i financimit
5.1	Zhvillimi i kapaciteteve organizative dhe njerëzore Masa/veprimtaria: Zbatimi dhe vlerësimi i strukturës organizative të miratuar, plotësimi i vendeve vakante sipas planit të rekrutimit dhe vlerësimi i nevojave shtesë që burojnë nga mandati i ri dhe ngarkesa e punës.	Kapacitete organizative më të përshtatura me funksionet dhe prioritetet strategjike.	100% e vendeve të autorizuar vakante të përfshira në planin e rekrutimit dhe procedurat e nisura sipas afateve; raport vjetor mbi ngarkesën, boshllëqet e aftësive dhe nevojat për burime.	Sekretari i Përgjithshëm; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës; drejtuesit e strukturave	2026 – 2027	Buxheti i institucionit
5.2	Modernizimi i proceseve dhe sistemeve të punës Masa/veprimtaria: Hartëzimi i proceseve prioritare dhe zhvillimi në faza i zgjidhjeve për menaxhimin e rasteve, ndjekjen e vendimeve/rekomandimeve dhe qarkullimin elektronik të dokumenteve, në varësi të financimit dhe procedurave të prokurimit.	Procese më të standardizuara, të gjurmueshme dhe efikase.	Proceset prioritare të hartuara; kërkesat funksionale dhe të sigurisë të miratuara; bazë matëse e kohës së trajtimit e krijuar; fazat e financuara të zhvilluara/testuara; objektivat e përmirësimit të miratuara pas krijimit të bazës matëse.	Sekretari i Përgjithshëm; sektori IT; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës; strukturat përdoruese	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
5.3	Monitorimi i Strategjisë dhe performancës institucionale Masa/veprimtaria: Miratimi i metodologjisë së monitorimit, krijimi i regjistrit/panelit të treguesve, raportimi gjashtëmuor dhe vjetor, si dhe hartimi i Planit të Veprimit 2028 – 2030.	Monitorim i rregullt, vendimarrje e bazuar në evidencë dhe vazhdimësi e zbatimit të Strategjisë.	Metodologjia dhe formatet e raportimit të miratuara; 2 raporte të brendshme në vit dhe 1 raport vjetor i konsoliduar; bazat matëse të plotësuara për treguesit ku mungojnë; Plani i Veprimit 2028 – 2030, i miratuar deri në T4 2027.	Sekretari i Përgjithshëm; Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; Grupi i Menaxhimit Strategjik; të gjitha strukturat	S2 2026 – T4 2027	Buxheti i institucionit
5.4	Zhvillimi profesional i stafit Masa/veprimtaria: Vlerësimi vjetor i nevojave për trajnim dhe zbatimi i një programi të vazhdueshëm zhvillimi profesional, me kombinim të trajnimeve të jashtme, trajnimeve të brendshme dhe shkëmbimit të njohurive.	Ekspertizë më e thelluar dhe shpërndarje më e mirë e njohurive brenda institucionit.	Analiza vjetore e nevojave dhe programi i miratuar; të paktën 80% e stafit pjesëmarrës në një aktivitet zhvillimi profesional çdo vit; të paktën 2 sesione të brendshme të shkëmbimit të njohurive në vit.	Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës; drejtuesit e strukturave; ASPA/partnerë	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
5.5	Siguria e informacionit dhe vazhdimësia e veprimtarisë Masa/veprimtaria: Kryerja e vlerësimit të rrezikut të sigurisë së informacionit dhe vazhdimësisë së veprimtarisë, miratimi i planit të masave dhe testimi periodik i rikuperimit/backup-it dhe procedurave të vazhdimësisë.	Rezistencë më e lartë institucionale dhe mbrojtje më e mirë e informacionit.	Vlerësimi i rrezikut dhe plani i masave të miratuara; regjistër i masave dhe statusit të tyre; të paktën 1 test i dokumentuar në vit; incidentet dhe masat korrigjuese të raportuara.	Sekretari i Përgjithshëm; sektori IT; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
5.6	Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar Masa/veprimtaria: Zhvillimi i bashkëpunimit me autoritetet publike, autoritetet homologe, rrjetet profesionale dhe partnerët ndërkombëtarë; përgatitja në kohë e kontributeve dhe raporteve të kërkuara; transferimi i njohurive brenda institucionit.	Bashkëpunim i orientuar drejt rezultateve dhe përdorim më i mirë i ekspertizës së përfituar.	100% e raportimeve të detyrueshme të dorëzuara në afat; numri i iniciativave dhe kontributeve substanciale; dokumentim i rezultateve; të paktën 2 sesione të brendshme në vit pas pjesëmarrjeve prioritare ndërkombëtare.	Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; strukturat përgjegjëse; Kabineti	2026 – 2027	Buxheti/partnerë zhvillimi
5.7	Mobilizimi i asistencës teknike dhe financiare Masa/veprimtaria: Identifikimi i nevojave të financueshme dhe hartimi i koncepteve/propozimeve për projekte që mbështesin zbatimin e prioritetëve strategjike, pa zëvendësuar financimin bazë institucional.	Portofol projektësh më i strukturuar dhe mundësi shtesë për zhvillim institucional.	Hartë vjetore e nevojave dhe burimeve të mundshme; të paktën 2 koncepte ose aplikime projekti deri në fund të vitit 2027; numri i marrëveshjeve të nënshkruara dhe masat e zbatuara, kur financimi sigurohet.	Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritetit; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës; strukturat përfutuese	2026 – 2027	Partnerë zhvillimi/bashkëfinancim sipas rastit

Strategjia e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2026–2030 përfaqëson angazhimin e institucionit për forcimin e transparencës, mbrojtjen efektive të të dhënave personale, qeverisjen e hapur, integritetin dhe llogaridhënien në epokën digjitale.

Përmes zbatimit të saj, Zyra e Komisionerit synon të konsolidojë më tej rolin e saj si autoritet i pavarur, profesional dhe i besueshëm, në shërbim të qytetarëve dhe në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Transparencë. Integritet. Mbrojtje e të drejtave. Besim.

Kjo Strategji është hartuar me mbështetjen e projektit **PACEP II**, financuar nga **Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)** dhe zbatuar nga **Global Partners Governance (GPG) Albania**.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



Global Partners
Governance